

ERMAL BAZE**INSTITUCIONET QEVERISËSE TË KOMUNËS SË SHKODRËS
(GJYSMA E PARË E SHEK. XIV)**

Nga fundi i dhjetëvjeçarit të dytë të shekullit XIII, qyteti i Shkodrës u vendos nën sundimin serb të dinastisë Nemanja¹, i cili zgjati deri në shpërbërjen e Perandorisë Serbe, pas vdekjes së Stefan Dushanit në vitin 1355². Shkodra zhvillohet në këtë kohë si komunë qytetare sipas modelit të qyteteve më të avancuara italo-dalmatine të Adriatikut lindor.

Shprehja më e lartë e organizimit komunal të qytetit të Shkodrës ishin statutet, të cilat përmbledhnin aktet normative që rregullonin në tërësinë e tyre organizimin e funksionimin e qytetit. Ekzistenca e këtij dokumenti përmendet në një bibliografi italiane të vitit 1907. Ky dokument është shkruar në pergamen dhe përmbante 40 faqe. Statutet e Shkodrës ruhen të plota, një kopje e të cilave u zbulua së fundi në fondin *Albanica* të “*Muzeut Correr*” në Venedik nga studiuesja italiane Lucia Nadin³, dhe u përkthyer në mënyrë të shkëlqyer dhe serioze në gjuhën shqipe, në vitin 2002 nga medievisti i njohur shqiptar Pëllumb Xhufi⁴.

¹ K. Jiriček, *Shkodra e krahina e saj në Mesjetë*, në: “Vëzhgime iliro-shqiptare” (përpiluar prej Dr. Ludwig Von Thalloczy, përkthyer në shqip nga Mustafa Merlika-Kruja), “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2004, f. 115; P. Cabanes, O. Chaline, B. Doumerci, A. Ducellier, M. Sivignon, *Historia e Adriatikut*, “Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit”, Tiranë, 2005, f. 179.

² Petrika Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar (395-1875)*, “Shblu”, Tiranë, 1999, f. 94; Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, “Pegi”, Tiranë, 2006, f. 288.

³ L. Nadin, L. Za, *Sugli antichi Statuti della città di Scutari*, në: “Studiuesit italianë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Universiteti i Shkodrës, “Volaj”, Shkodër, 1997, f.41-45.

⁴ *Statuti di Scutari della prima metà del secolo XIV con le addizione fino al 1469*, (a cura di Lucia Nadin, traduzione in albanese a cura di Pëllumb Xhufi), “Viella”, Roma, 2002.

Ato përbëhen nga 279 kapituj shkruar në venecianishten e shekullit XV⁵. Ndërsa pjesë të zgjeruara janë shkruar me sa kuptohet në dialektin roman të zonës, i cili bën pjesë në gjuhën dalmate⁶, data e hartimit të tyre “*si terminus ante quem do të vlejë viti 1346*”, sipas mendimit të albanologut zvicerian Oliver Jens Schmitt⁷. Pas këtij viti Statutet e Shkodrës janë pasuruar me disa amendamente: gjashtë shtojca në vitet 1391 – 1393⁸, si dhe pesë dispozita nga periudha veneciane 1457 – 1469⁹.

Si dokumenti themeltar juridik i administrimit dhe i organizimit institucional të qytetit, statutet ishin në dy kopje: njëra të ruhej në thesarin e komunës, ndërsa tjetra në gjykatë me qëllim përdorimin e saj gjatë gjykimit¹⁰. Gjithashtu, normave të këtij statuti ishin të detyruar t’u bindeshin të gjithë, si banorët e komunës ashtu edhe të huajt që vinin në qytet. “*Nëse një qytetar ose një i huaj kërkon të justifikohet duke thënë se nuk i njeh dispozitat e statutit, justifikimi të mos merret parasysh dhe personi në fjalë të shlyejë dënimin sipas fajit*”¹¹. “*Aktet që bien në kundërshtim me statutin quhen të paqëna dhe të pavlera*”¹².

E drejta sovrane mbi qytetin e Shkodrës në këtë periudhë i përkiste mbretit serb, Stefan Dushanit (1331 – 1355)¹³. Autoriteti i tij mbretëror përfaqësohej nga konti, i cili dëshmohet jo vetëm gjatë kohës së mbretërisë dhe perandorisë serbe, por edhe gjatë sundimit të Balshajve në viset e Shqipërisë Veriore, çka hedh dritë mbi vazhdimësinë e administratës në formacionet politike e shtetërore që pasuan Perandorinë mesjetare Serbe¹⁴. “*Zyrtari politik ma i nalti i qytetit ishte comesi (konti). Në vitin 1347 përmendet një farë Comes Petrus Chranimiri*”¹⁵.

⁵ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I, botim i Akademisë së Shkencave, Instituti i Historisë, “Toena”, Tiranë, 2002, f. 266. (Vetëm 278 kapituj janë me tekste të plota, pasi kreut 66 i mungon krejtësisht përmbajtja - Shënim i autorit).

⁶ Oliver J. Schmitt, *Arbëria venedike (1392-1479)*, “K&B”, Tiranë, 2007, f. 112.

⁷ *Po aty*, f. 113.

⁸ *Statuti di Scutari ...*, kreu 271, 272, 273, 274.

⁹ *Po aty*, kreu 275, 276, 278, 279.

¹⁰ *Po aty*, kreu 4.

¹¹ *Po aty*, kreu 5.

¹² *Po aty*, kreu 6.

¹³ *Po aty*, kreu 1, 2, 3, 31, 55, 85, 92, 99, 224, 225.

¹⁴ *Statuti di Scutari ...*, kreu 274: edhe pak kohë para pushtimit osman të Shkodrës (pas majit 1393), komuna rregullonte të ardhurat e kontit (dita e dhjetë marsit 1393).

¹⁵ K. Jiriček, *vep. e për.*, f. 118.

Ai ishte një figurë e rëndësishme politike e institucionale dhe ruhej me ligj integriteti i tij moral¹⁶ dhe fizik¹⁷. Konti si përfaqësues i sundimitarit të vendit, shumë shpesh mbante gjysmën e një gjobe të vënë nga komuna për shkelësit e ligjit¹⁸; gjysma tjetër i shkonte komunës¹⁹ ose të dëmtuarit²⁰; ndërsa vetëm me përjashtim të një rasti ai mbante një të katërtën e gjobës²¹. Konti, përveçse si përfitues i këtyre pagesave, thuajse nuk shfaqet gjetiu në statutet. Ai kufizohej thjesht me përfaqësimin e sundimit serb e sa për të tjerat duhej të respektonte vetëadministrimin e komunës.

Një organ tjetër i lartë në qeverisjen e qytetit, ishte asambleja e thjeshtë popullore nën mbikqyrjen peshkopit dhe fisnikëve më të rëndësishëm të komunës. Mbledhja e popullit i zhvillonte punimet në sheshin kryesor të qytetit, me pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve meshkuj në moshë të rritur, pavarësisht nga shtresa në të cilën bënin pjesë²². Kompetencat më të rëndësishme të mbledhjes së popullit ishin zgjedhja periodike e organeve të qeverisjes së qytetit, miratimi ose ndryshimi i statutit që luante rolin e ligjit themelor për administrimin e qytetit, si dhe zgjidhja e problemeve veçanërisht të rëndësishme për të cilat nevojitej pëlqimi i të gjithë qytetarëve²³.

Në Shkodër mbledhja e qytetarëve bëhej ditën e Shën Markut, më 25 prill. Atë ditë këmbanat e Shën Stefanit ftonin popullin të grumbullohej në sheshin para katedrales, ku në praninë e peshkopit dhe të parisë së qytetit bëhej përzgjedhja e tre gjyqtarëve, e tetë këshilltarëve dhe e dy financierëve të

¹⁶ Statuti di Scutari ..., kreu 257.

¹⁷ Po aty, kreu 229: "Kur dikush godet kontin përpara gjykatësve, detyrohet të paguajë tetë hyperperë, gjysmat për kontin dhe gjysmat për komunën".

¹⁸ Statuti di Scutari ..., kreu 12, 13, 16, 19, 21, 22, 24, 25, 28, 29, 30, 36, 39, 40, 42, 46, 47, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 84, 85, 86, 87, 93, 115, 151, 152, 163, 184, 187, 201, 202, 203, 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 216, 218, 223, 229, 230, 231, 232, 233, 237, 238, 239, 242, 243, 246, 249, 251, 256, 257, 260, 261, 262, 265.

¹⁹ Po aty, kreu 19, 22, 24, 30, 64, 67, 68, 69, 70, 72, 73, 74, 77, 79, 80, 81, 84, 85, 86, 93, 115, 151, 152, 223, 229, 246, 249, 250, 251, 260, 262.

²⁰ Po aty, kreu 12, 13, 16, 21, 25, 28, 29, 36, 39, 40, 42, 46, 47, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 71, 76, 78, 87, 163, 184, 187, 201, 203, 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 216, 218, 230, 231, 232, 233, 237, 238, 239, 240, 242, 243, 256, 257, 261, 265.

²¹ Po aty, kreu 200.

²² Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri, botim i tretë, University Press "Luarasi", Tiranë, 2005, f. 111.

²³ Po aty, f. 111.

komunës²⁴. Secili prej të zgjedhurve duhej të merrte funksionet e tij brenda tri ditëve²⁵. Mandati i qeverisjes së tyre në organet më të larta të komunës ishte një vit²⁶.

Gjykatësit, këshilltarët, financierët bashkë me më të shquarit e qytetarëve²⁷ (boni homines) ishin anëtarët e një asambleje më të ngushtë, Këshillit komunal²⁸. Këshilli komunal trajtonte çështje që kishin të bënin me besnikërinë dhe me integritetin moral të qytetarëve e të nëpunësve komunalë, si dhe me zgjedhjen e një radhe tjetër nëpunësish, mes të cilëve noterët²⁹, sekretarët e gjyqit (*cancellarius*)³⁰ dhe përmbaruesit (*semecio*; *otargo*)³¹. Këta të fundit ishin të përjashtuar nga taksat³² dhe mbroheshin me ligj në rastet e ushtrimit të dhunës fizike ndaj personit të tyre, kur ishin në shërbim të komunës³³.

²⁴ Statuti di Scutari..., kreu 89: “Urdhërojmë që çdo vit ditën e Shën Mark Engjëllorit, të bëhet betimi për tre gjykatës, tetë këshilltarë, dhe dy intendentë. Atë ditë të bien këmbanat e Shën Stefanit, të mblidhet populli dhe të vijë peshkopi ynë, i cili së bashku me katër fisnikë do të zgjedhë nëpunësit e mësipërm si dhe gjykatësit dhe këshilltarët. Nëse peshkopi nuk ndodhet në provincë do të paraqiten tre fisnikë laikë vendas, të cilët do të betohen mbi ungjill se nuk do të zgjedhin kënd për miqësi dhe as do të rrëzojnë kënd për armiqësi. Zgjedhja do të bazohet vetëm në aftësitë dhe në përkushtimin e gjithsecilit prej tyre në qytetin tonë”.

²⁵ Po aty, kreu 90: “Nëse një nëpunës i zgjedhur nga komuna nuk pranon të kryejë një porosi, t’i jepet atij një afat prej tri ditësh dhe nëse pas tri ditëve nuk e ka vënë atë në vend, të dënohet me tetë hyperperë gjobë dhe veç kësaj të qëndrojë në krye të detyrës dhe të mos i merret parasysh asnjë lloj justifikimi”.

²⁶ Po aty, kreu 152: “Asnjë funksionar nuk mund të qëndrojë në detyrë më shumë se një vit, me përjashtim të avokatit apo të ndonjë personi tjetër që gjykohet i dobishëm nga komuna dhe që mund të mbahet derisa kjo të dëshirojë. Kundravajtja dënohet me tetë hyperperë gjobë, që ndahen mes kontit dhe komunës”.

²⁷ Po aty, kreu 93.

²⁸ Historia e Popullit Shqiptar, vëll. I, f. 265.

²⁹ Statuti di Scutari ..., kreu 93.

³⁰ Po aty, kreu 104.

³¹ Po aty, kreu 103, 106, 176, 179.

³² Po aty, kreu 56: “Shtëpitë e të gjithë atyre që ditën e Shën Stefanit emërohen, noter, semec ose vatak të komunës sonë, nuk i detyrohen asaj asgjë dhe janë të lirë e të përjashtuar nga çdo taksë”.

³³ Po aty, kreu 231: “Kur qëllohet noteri ose sekretari gjatë procesit, fajtori paguan njëzet e pesë hyperperë. Kur këtë e bën jashtë sallës së gjyqit, paguan dymbëdhjetë hyperperë, që ndahen përgjysëm midis kontit dhe viktimës”. Kreu 232: “Cilido që qëllon semecin ose otargun gjatë gjykimit, dënohet me nëntë hyperperë gjobë; nëse jashtë sallës së gjyqit, me katër hyperperë, dy për kontin dhe dy për të rrahurin”. Kreu 233: “Kur dikush rreh një nëpunës të komunës, i cili është në

Kolegji i Gjykatësve së bashku me Këshillin përbënte qeverinë e qytetit, me vendime që miratoheshin me konsensus dhe me shumicë votash³⁴. Miratimi i mbretit përbënte bazën juridike dhe politike të kushtetutës qytetare shkodrane³⁵. Ai i kishte akorduar komunës, përkatësisht gjykatësve të saj juridiksion të zgjeruar mbi qytetarët, banorët sllavë e arbër etnikë të krahinave përreth si dhe të huaj, me përjashtim të katër çështjeve gjyqësore që gjykoheshin nga vetë mbreti: këto kishin të bënin me tradhtinë bashkëshortore, me vrasjen si dhe të drejtën mbi shërbëtorët e shërbëtorët dhe me vrasjen e kuajve³⁶. Këto ishin rezervate të vjetra të kurorës serbe³⁷.

Në të gjithë strukturën piramidale të qeverisjes komunale të Shkodrës, gjykatësit kishin një rëndësi shumë të madhe, e cila shfaqej në detyrat dhe kompetencat e tyre në shumë aspekte të kontrollit e drejtimit të qytetit. Ata merrnin pjesë në matjen e trojeve³⁸ dhe mbikqymnin rregulloren e ndërtimit³⁹; jepnin leje për prerjen e pemëve të mbjella jashtë rregullave⁴⁰; vendosnin me autoritetin e tyre për gjobat e ulëta; duhej të caktonin kontrollorin e masave, peshave e pashëve⁴¹; duhej të kontrollonin kasapët që nuk paguanin doganën e thertores⁴²; jepnin leje për shitjen e mishit⁴³; jepnin së bashku me Këshillin leje eksportimi për drithëra⁴⁴ e ushqime⁴⁵; komandonin së bashku me Këshillin

shërbim të saj, fajtori paguan shtatë hyperperë që ndahen njëllor mes kontit dhe të dëmtuarit".

³⁴ *Po aty, kreu 98: "Konsiderohen si të vlefshme dhe të pandryshueshme të gjitha vendimet e marra në mirëkuptim nga gjykatësit dhe këshilltarët. Nëse mungon konsensusi, të kthehet në votim dhe të bëhet vullneti i atij që fiton shumicën"*.

³⁵ *Po aty, kreu 2.*

³⁶ *Po aty, kreu 2.*

³⁷ O. J. Schmitt, *vep. e për.*, f. 115.

³⁸ *Statuti di Scutari...*, kreu 8.

³⁹ *Po aty, kreu 12, 19.*

⁴⁰ *Po aty, kreu 40.*

⁴¹ *Po aty, kreu 64: "Masat, peshët dhe pashët në dheun tonë duhet të jenë të njëjta. Nëse dikush kapet me të tilla jashtë standardit, dënohet me tetë hyperperë sklavonie. Nëse dikush bën punën e kontrollorit pa pasur mandatin e komunës ose dikush tjetër i caktuar me këtë detyrë nuk e bën atë si duhet, ai duhet të paguajë po atë sasi gjobe, që shkon në favor të kontit dhe të komunës. Gjykatësit duhet të kujdesen që një detyrë e tillë t'i caktohet një njeriu sa më të ndershëm."*; Kreu 109.

⁴² *Po aty, kreu 65.*

⁴³ *Po aty, kreu 109.*

⁴⁴ *Po aty, kreu 68.*

⁴⁵ *Po aty, kreu 67, 69.*

rojet e sigurisë publike të qytetit⁴⁶; secili nga gjykatësit mbante njërin prej çelësave të arkës së komunës, ku ndodheshin vula dhe privilegjet e qytetit⁴⁷; së bashku me Këshillin, ata duhej të prisnin me nderimet e duhura dhe të mbanin me shpenzimet e komunës të dërguarit ose oborrtarët e mbretit⁴⁸; ata merrnin pjesë së bashku me Këshillin në zgjedhjen e noterit⁴⁹ dhe të sekretarit të gjyqit⁵⁰; ata ishin eprorët e drejtpërdrejtë të sekretarit të gjyqit⁵¹; së bashku me Këshillin, gjykatësit duhej të mbikqyrnin financierët e komunës⁵²; u jepnin udhëzime nëpunësve të përmbarimit⁵³; kontrollonin njerëzit e ngarkuar me mbledhjen e detyrimeve nga komuna⁵⁴; duhej të detyronin debitorët e komunës

⁴⁶ *Po aty*, kreu 86: “*Qoftë kapedanët që varen nga gjykatësit, qoftë kapedanët e rojeve të qytetit, duhet të betohen se janë të gatshëm t’i binden ditën e natën çdo urdhri të Këshillit ose të gjykatësve të qytetit, siç e do nderi dhe interesi në qytetin tonë. Por nëse ata do të bënin ndonjë veprim me kokën e tyre, pa pasur urdhër nga gjykatësi, ata do të humbnin postin e tyre dhe do të gjobiten me katër hyperperë, që ndahen midis komunës dhe kontit*”.

⁴⁷ *Po aty*, kreu 88: “*Arka e komunës ku ruhen vula dhe privilegjet e qytetit, duhet të ketë tre çelësa dhe çdonjëri prej gjykatësve të ketë një çelës. Nëse dikush pajiset me dokument privilegji nga komuna, duhet t’ja dorëzojë atë gjykatësve. Nëse vërtetohet se nuk e ka bërë një gjë të tillë, do t’i japë komunës tetë hyperperë sklavonie*”.

⁴⁸ *Po aty*, kreu 99.

⁴⁹ *Po aty*, kreu 93.

⁵⁰ *Po aty*, kreu 104: “*Sekretari duhet të zgjidhet nga gjykatësit dhe Këshilli. I zgjedhuri duhet të betohet mbi ungjill se do të jetë besnik dhe i bindur ndaj çdo urdhëri të gjykatësve, se gjatë gjyqit ashtu siç e thonë statutet, do të shkruajë besnikërisht në fletore të gjitha sa deklarohen nga palët si dhe vendimin e dhënë nga gjykatësit. Më tej, duhet të plotësojë një shkresë, që pasi ta lexojë, duhet t’ia kalojë noterit në prani të gjykatësve. Nëse shkel ndonjë nga procedurat e mësipërme, sekretari humbet postin dhe pagën. Paga e tij është 15 hyperperë. Për më tepër, shtëpia e sekretarit përjashtohet nga çdo lloj takse*”.

⁵¹ *Po aty*, kreu 104.

⁵² *Po aty*, kreu 105.

⁵³ *Po aty*, kreu 106.

⁵⁴ *Po aty*, kreu 108: “*Njerëzit e ngarkuar me mbledhjen e detyrimeve nga komuna, ta bëjnë këtë punë siç u është thënë, me ndershmëri dhe pa hile. Përveç kësaj t’u raportojnë me përpikmëri gjykatësve dhe komunës. Nëse veprojnë ndryshe, të dënohen me tetë hyperperë gjobë. Përveç kësaj të paguajnë dëmin dhe të përjashtohen përgjithmonë nga postet zyrtare*”.

për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura⁵⁵ si dhe njoftonin me korrier të paditurit në gjyq⁵⁶.

Për veprimtarinë dhe aktivitetin profesional të gjykatësve në qytetin e Shkodrës dhe për parimet e principet që ata duhet të ndiqnin në kryerjen e funksionit të tyre në fushën e gjyqësorit, statutet bëjnë fjalë si më poshtë: “Gjatë kohës që është në detyrë gjykatësi duhet t`u ofrojë shërbimet e tij të gjithë atyre që i paraqisnin hallin e tyre dhe të gjykojë mbi bazën e statuteve të qytetit me ndershmëri dhe përpikmëri, pa u joshur nga miqësitë. Gjatë vitit të shërbimit si gjykatës, ai nuk duhet të marrë rolin e avokatit për askënd. Detyra e tij është të dëgjojë të dyja palët, të regjistrojë me anën e sekretarit shpjegimet e secilës palë dhe të japë vendim të drejtë sipas statuteve dhe zakoneve të qytetit”⁵⁷.

Kohëzgjatja e ushtrimit të detyrës së gjykatësve zgjaste një vit⁵⁸ dhe ishin të ndaluara fyerjet⁵⁹ apo përdorimi i dhunës fizike⁶⁰ ndaj tyre. Ata i merrnin pagat mbi bazën e taksës gjyqësore “sudebina”⁶¹. Marrja e ryshfeteve apo përfshirja e gjykatësve në afera të ndryshme korruptive, rezultonte e rëndë dhe

⁵⁵ Po aty, kreu 138: “Gjykatësit e kanë për detyrë t`i shtrëngojnë borxhlinjtë e komunës t`i kthejnë kësaj të gjitha sa i detyrohen nga tatimet, nga shitjet e nga çdo gjë tjetër”.

⁵⁶ Po aty, kreu 137.

⁵⁷ Po aty, kreu 97.

⁵⁸ Po aty, kreu 110: “Gjykatësit e zgjedhur dhe që kanë bërë betimin, gjatë vitit që janë në detyrë, duhet të besohen për gjithë sa bëhet dhe thuhet në prani të tyre. Me kalimin e vitit atij nuk mund t`i besohet më shumë nga ç`do t`i besohej një njeriu të zakonshëm”.

⁵⁹ Po aty, kreu 257: “Kur një person në gjykim, guxon të fyejë gjykatësit, statutet ose kontin, detyrohet të paguajë një gjobë prej tetë hyperperësh dhe humb automatikisht gjyqin. Gjysma e gjobës i kalon kontit dhe gjysma tjetër personit të fyer”.

⁶⁰ Po aty, kreu 230: “Kur dikush godet gjykatësin ose ndonjërin prej gjykatësve gjatë procesit, dënohet me tridhjetë hyperperë dhe me humbjen e çështjes. Nëse e godet jashtë sallës së gjyqit dhe nëse fakti provohet, detyrohet të paguajë pesëmbëdhjetë hyperperë, gjysmën për kontin dhe gjysmën për viktimën”.

⁶¹ Po aty, kreu 103: “Gjykatësit e betuar të dheut tonë nuk duhet të kenë asnjë pagë veç sudebinës dhe së dhjetës së vlerës së përftuar nga çdo shitje. Sudebina nxirret nga proceset gjyqësore. Për çdo titull prone, për çdo kafshë apo borxh nga tetë hyperperë e lart, sudebina duhet të jetë katër grosh dhe duhet të vilet nga ai që e fiton gjyqin. Atij që e humb gjyqin, përmbaruesi (semeci) i merr peng sende si për sudebinën ashtu edhe për shpenzimet e tjera dhe këto sende i dorëzohen fituesit të gjyqit”.

fatale për karrierën e tyre profesionale⁶². E njëjta gjë vlente edhe për noterët dhe funksionarët e tjerë të komunës⁶³.

Në mbarëvajtjen e punës së tyre dhe për zhvillimin e një procesi të rregullt gjyqësor, ata ndihmoheshin prej sekretarit të gjyqit. Ky i fundit zgjidhej nga vetë gjykatësit dhe duhej të bënte betimin mbi ungjill për besnikëri dhe bindje institucionale ndaj çdo urdhri dhe vendimi të tyre⁶⁴. Detyra kryesore e sekretarit të gjyqit ishte mbajtja shënim në mënyrë sa më të plotë e të saktë e të dëshmimeve të të dy palëve, si dhe vendimin e dhënë nga gjykatësit.

Përveç sekretarit ose kancelarit, në një proces gjyqësor merrnin pjesë edhe semeci dhe otargu, të cilët “*duhet të bënin betimin dhe t’ju bindeshin urdhrave të gjykatësve gjatë ditës, natës apo në çdo orë, si dhe të kryenin shërbimet e komunës besnikërisht e pa hile*”⁶⁵. “*Ata duhet të njoftojnë çdo njeri që thirret në gjyq dhe të qëndrojnë e të dëgjojnë ç’thuhet bashkë me gjykatësit, kur këta janë duke bërë punën e tyre. Nëse nuk binden të veprojnë kështu, të dënohen me tetë hyperperë dhe të shkarkohen nga detyra si semeci ashtu edhe otargu*”⁶⁶. Gjithashtu, ata kryenin edhe funksionin e përmbaruesve, duke konfiskuar pronat apo sendet e atyre që humbisnin gjyqin⁶⁷; bënin shpalljen për shitjen e pronave të qytetarëve të ndryshëm⁶⁸, si dhe merreshin me shitjen dhe caktimin e çmimeve të sendeve që liheshin peng⁶⁹.

Të dielave dhe gjatë festave fetare, gjyqtarëve u ndalohej në mënyrë kategorike që të zhvillonin procese gjyqësore midis dy qytetarëve të komunës, midis dy të huajve apo ndërmjet një qytetari dhe një të huaji⁷⁰. Pezullimi i

⁶² *Po aty*, kreu 156: “*Nëse një gjykatës merr të holla për një gjyq dhe nëse një gjë e tillë provohet, ai detyrohet të paguajë tetë hyperperë gjobë, që ndahen përgjysëm midis kontit dhe komunës. Nga ana tjetër detyrohet t’i paguajë dëmin atij që e ka humbur gjyqin për shkak të tij. Më në fund ai humb përgjithmonë të drejtën për të ushtruar profesionin e tij në komunën tonë. E njëjta gjë vlen edhe për noterin dhe për çdo funksionar të Komunës sonë*”.

⁶³ *Po aty*.

⁶⁴ *Po aty*, kreu 104.

⁶⁵ *Po aty*, kreu 106.

⁶⁶ *Po aty*, kreu 106.

⁶⁷ *Po aty*, kreu 103, 179.

⁶⁸ *Po aty*, kreu 176: “*Kur një person dëshironte të shiste një pronë të tijën, ai duhej të porosiste që të binin këmbanat e Shën Stefanit tri herë gjatë tri të dielave, dhe të shpallte nëpërmjet otargut ose semecit, se filan njeri shiste filan pronë...*”.

⁶⁹ *Po aty*, kreu 179.

⁷⁰ *Po aty*, kreu 113: “*I ndalohet çdo gjykatësi të gjykojë çështje midis dy qytetarëve, po ashtu midis dy të huajve ose midis një qytetari dhe një të huaji, të*

veprimtarisë së gjykatave gjatë kohës së festave të rëndësishme fetare dhe festës së shenjtorit të qytetit, ishte miratuar edhe nga autoriteti mbretëror⁷¹.

Shkalla e rëndësisë së një gjyqi dhe koha e zhvillimit të tij vareshin nga vlera financiare e çështjeve. *“Kur ndonjëri hap gjyq për çështje prone ose për shuma nga tetë hyperperë e lart, gjyqi të bëhet brenda pesëmbëdhjetë ditëve, kurse për çështje me më pak se tetë hyperperë të vendosin gjykatësit”*⁷². Formimi i trupit gjykues bëhej vetëm me miratimin e të dy palëve në konflikt e në prani të dy gjykatësve, si dhe kur çështja e kalonte shumën e dy hyperperëve⁷³. Gjykatësi mund të refuzohej gjatë një procesi gjyqësor vetëm në ato raste, kur ai kishte marrëdhënie farefisnie apo nepotike me njërin nga palët në konflikt⁷⁴.

Momentet më të rëndësishme në zhvillimin e një gjyqi ishin paraqitja e provave⁷⁵ nga të dy palët si dhe thirrja e dëshmitarëve⁷⁶ dhe e garantëve⁷⁷, të cilët duhet të betoheshin mbi ungill⁷⁸ se do të tregonin vetëm të vërtetën. Dëshmitarët thirreshin në gjyq nga korrieri dhe vataku, të cilët ishin të detyruar ta bënin këtë gjë tri herë me radhë⁷⁹. Në rast se dëshmitari nuk paraqitej edhe pas herës së tretë, ose paraqitej dhe refuzonte të dëshmonte, ai ishte i detyruar të paguante të gjithë dëmin e palës që humbiste gjyqin⁸⁰. Gjithashtu, nëse dëshmitari qoftë burrë apo

dielave, gjatë Krishtlindjeve, Karnavaleve, Epifanisë apo në festat që lidhen me Shën Mërinë dhe me Ngjytjen në qiell”.

⁷¹ *Po aty*, kreu 3.

⁷² *Po aty*, kreu 119.

⁷³ *Po aty*, kreu 111: *“Nëse në një proces gjyqësor njëra palë pyet tjetrën: “a je dakord me këtë trup gjykues” dhe pala tjetër përgjigjet: “jam dakord”, ky pranim nuk vlen e nuk quhet nëse nuk ndodhen dy gjykatës të pranishëm që të gjykojnë për çdo çështje nga dy hyperperë e sipër”.*

⁷⁴ *Po aty*, kreu 112: *“Askush nuk mund të refuzojë pa arsye asnjë nga gjykatësit në gjykim, përveç rasti kur është kushëri i një gjaku, vëlla, gjysh, dhëndër, nip, vjehrr, kunat, kumbar si nga ana e burrit, ashtu edhe nga ana e gruas. Nëse gjykatësi tjetër këshillohet me gjykatësin e kontestuar për arsyet e mësipërme, ai dënohet me tetë hyperperë gjobë dhe vendimi të quhet i paqenë dhe i pavlefshëm”.*

⁷⁵ *Po aty*, kreu 118, 131.

⁷⁶ *Po aty*, kreu 128, 132, 133.

⁷⁷ *Po aty*, kreu 130, 134.

⁷⁸ *Po aty*, kreu 134, 137.

⁷⁹ *Po aty*, kreu 137.

⁸⁰ *Po aty*, kreu 137.

grua, ishte i pamundur nga gjendja fizike, “gjykatësi së bashku me sekretarin shkonin në shtëpinë e të sëmurit, të cilin e ftonin të betohej mbi ungjill se do të thoshte të vërtetën”⁸¹. Sanksione jo të lehta ndëshkimi parashikoheshin për dëshmitarët e rremë dhe për personat, që i rekomandonin dhe i paraqisnin ata në gjyq⁸². Gjorbë në të holla parashikohej edhe për ata persona, që dëshironin të merrnin pjesë në një proces gjyqësor dhe bënëin zhurmë gjatë zhvillimit të tij⁸³.

Ajo palë që nuk paraqitej⁸⁴ ose refuzonte të përgjigjej në gjyq⁸⁵, e humbiste çështjen për të cilën kishte ngritur padinë. Sipas statuteve: “Askush nuk mund të dënohej pa u dëgjuar dëshmia e dy ose e tre personave”⁸⁶. Gjykatësit ishin të detyruar të shpallnin vendimin e gjyqit brenda pesëmbëdhjetë ditëve pas mbylljes së çështjes⁸⁷. “Nëse ky afat shkelej, gjykatësit fajtorë për mosshpalljen e vendimit detyroheshin të paguanin për dëmin nëntë hyperperë sklavonie; nëse dikush i kundërvihet vendimit të gjykatësve të dhënë sipas statuteve, dënohej me 20 hyperpreë, që ndahen midis kontit dhe gjykatësve; dhe nëse vendimi binte në kundërshtim me statutet, ai konsiderohej i pavlefshëm, pasi ishte e detyrueshme që vendimi i gjykatësve të gjente mbështetje te statutet”⁸⁸.

Megjithatë, nëse gjykatësit ballafaqoheshin me një rast juridik që nuk ishte i parashikuar në statutet e qytetit, ata nuk duhet të dilnin me një vendim pa pasur në besë mbështetjen e tre ose katër fisnikëve të qytetit⁸⁹. Pasi gjykatësit të kishin dhënë vendimin e tyre në bashkëpunim me

⁸¹ *Po aty*, kreu 137.

⁸² *Po aty*, kreu 139: “Kur një dëshmitar i shtyrë nga ligësia e tij ose i joshur nga të hollat, jep dëshmi të rreme në dëm të dikujt, dhe kur një gjë e tillë provohet, ai detyrohet të paguajë të gjithë dëmin si dhe një gjorbë prej tetë hyperperësh, gjysma për kontin e gjysma të dëmtuarit. Përveç kësaj një dëshmitar i tillë nuk do të thirret më të dëshmojë dhe nuk mund të shpresojë më për ndonjë ofiq në komunë. Të njëjtat sanksione vlejné edhe për ata të cilët rekomandojnë dhe paraqesin dëshmitarë të rremë”.

⁸³ *Po aty*, kreu 263: “Të gjithë ata që dëshirojnë të marrin pjesë gjatë një gjykimi, duhet të dëgjojnë e të heshtin. Nëse dikush ndërhyr në favor të kësaj apo asaj pale, ai detyrohet të paguajë dymbëdhjetë hyperperë”.

⁸⁴ *Po aty*, kreu 115.

⁸⁵ *Po aty*, kreu 116.

⁸⁶ *Po aty*, kreu 125.

⁸⁷ *Po aty*, kreu 151.

⁸⁸ *Po aty*, kreu 151.

⁸⁹ *Po aty*, kreu 68, 268.

fisnikët më të shquar të komunës, këta të fundit duhej ta hidhin atë në librin juridik të qytetit, në mënyrë që nëse paraqitej nevoja e gjykimit të së njëjtës çështje, të procedohej normalisht mbi bazën e statuteve⁹⁰.

Gjithashtu, në Statutet e Shkodrës nuk mungonin edhe rastet kur gjykatësi duhej të gjykonte bashkë me peshkopin ose mëkëmbësin e tij një çështje gjyqësore⁹¹. Kjo ndodhte kur një klerik padiste një laik⁹². Gjykatësi nuk kishte të drejtë të detyronte një klerik të thirrur si dëshmitar, që të betohej përpara tij. Mjaft që kleriku të betohej përpara autoriteteve fetare, qoftë edhe në prani të gjykatësve⁹³. Një situatë e ngjashme ishte edhe kur bëhej fjalë për pronat kishtare. *“Nëse bëhej fjalë për prona kishë, kleriku nuk ishte i detyruar të paraqitej para gjykatësve”*⁹⁴.

Nga sa trajtuam edhe më sipër, mund të arrijmë në përfundimin se, gjykatësit e qytetit të Shkodrës ishin jo vetëm drejtuesit e sistemit juridik, por kishin edhe një autoritet ekzekutiv me kompetenca të gjëra në milici, ekonomi dhe administratë.

Bashkëpunëtor i ngushtë me Kolegjin e Gjykatësve në qeverisjen e komunës, ishte edhe Këshilli⁹⁵. *“Këshilli (“conseglio”) i Shkodrës me vetëm tetë anëtarët e tij (“consiglieri”) kishte një përbërje modeste në krahasim me këshillat e qyteteve dalmate në gjysmën e parë të shekullit XIV”*⁹⁶. Ai nuk përfaqësonte si në Venedik⁹⁷ dhe në një numër komunash dalmate një institucion, i cili përmbledhte vetëm fisnikë si një grup i mbyllur e i privilegjuar politikisht dhe ekonomikisht kundrejt jofisnikëve⁹⁸.

Anëtarët e Këshillit të Shkodrës në shumë veprimtari shfaqeshin si autoritet ekzekutiv së bashku me gjykatësit⁹⁹. Epërsia e tyre numerike në vendime që duheshin marrë së bashku i privilegjonte në një farë mase, por megjithatë nga statutet del e qartë se korpusi i gjykatësve gëzonte një

⁹⁰ *Po aty*, kreu 68, 268.

⁹¹ *Po aty*, kreu 144.

⁹² *Po aty*, kreu 144.

⁹³ *Po aty*, kreu 148.

⁹⁴ *Po aty*, kreu 145.

⁹⁵ *Po aty*, kreu 67, 68, 69, 86, 89, 98, 99, 100, 101, 102, 104, 105.

⁹⁶ O. J. Schmitt, *vep. e për.*, f. 121.

⁹⁷ F. C. Lane, *Storia di Venezia*, seconda edizione, “Einaudi”, Torino, 1991, f. 114, 131, 134-135; Ch. Diehl, *La Repubblica di Venezia*, “Newton & Compton”, Roma, 2004, p.83-84.

⁹⁸ O. J. Schmitt, *vep. e për.*, f. 121.

⁹⁹ *Statuti di Scutari...*, kreu 67, 68, 69, 86, 89, 98, 99, 100, 105.

status edhe më të lartë se gjykatësit, për shembull në milici dhe në përfaqësimin e komunës nga jashtë, kishin kompetenca më të mëdha se sa anëtarët e Këshillit. Megjithatë, gjykatësit rrallë mund të merrnin vendime pa miratimin formal të anëtarëve të Këshillit¹⁰⁰.

Këshilli asgjekund nuk kishte kompetenca vetëm të vetat, ai gjithmonë bashkëpunonte me gjykatësit. Vetëm tri dispozita të statutit merren gjerësisht me Këshillin, e këto rregullojnë mënyrat e procedimit¹⁰¹, si për shembull detyrimin për mosnxjerrjen e sekreteve gjatë ushtrimit të funksionit¹⁰² ose mbrojtjen ndaj raprezaljeve si reagim ndaj një kërkesë të dobishme të një pjesëtarit të Këshillit¹⁰³.

Organi i tretë politik në qytetin e Shkodrës përfaqësohej nga dy administratorët e financave, të cilët regjistronin të gjitha të ardhurat e shpenzimet e komunës dhe duhej t'i jepnin llogari çdo tre muaj Këshillit dhe Kolegjit të Gjykatësve¹⁰⁴. Të ardhurat, që vinin kryesisht nga

¹⁰⁰ Po aty, kreu 99: “Kur në qytet vjen i dërguari i mbretit ose oborrtari i tij, gjykatësit bashkë me Këshillin duhet t'i bëjnë nderimet e duhura, duke i ofruar për të ngrënë e për të pirë. Nëse ndokush prej bujtësve do të kërkonte dhurata, gjykatësi të mos ia japë pa u marrë vesh me këshilltarët”.

¹⁰¹ Po aty, kreu 100: “Në rast se një person, qytetar i yni, ka probleme me komunën, do të mblidhet këshilli dhe nëse aty gjendet ndonjë i afërm i tij, ai duhet nxjerrë jashtë Këshillit, derisa të sqarohet puna me personin në fjalë, pra deri sa të paraqiten dëshmitarët sipas statutit dhe personi në fjalë të dënohet. Gjykatësi dhe Këshilli të vazhdojnë të rrinë të mbledhur derisa të detyrojnë personin të pranojë fajin”.

¹⁰² Po aty, kreu 101: “I ndalohet çdo anëtarit të Këshillit të nxjerrë jashtë çështjet që diskutohen në të. Në rast kundravajtje të paguajë tetë hyperperë gjobë dhe të mos pranohet kurrë më në poste bashkiake”.

¹⁰³ Po aty, kreu 102: “Kur një këshilltar ose gjykatës thotë në mbledhjen e Këshillit fjalë që i vlej në komunës dhe për shkak të tyre pëson ndonjë dëm, komuna është e detyruar ta dëmshpërblejë. Nëse ndokush nuk dëshiron ta bëjë një gjë të tillë, të dënohet me tetë hyperperë gjobë, që ndahen midis komunës e të dëmtuarit. Ky i fundit përveç kësaj do të marrë edhe dëmshpërblim”.

¹⁰⁴ Po aty, kreu 105: “Të gjitha të ardhurat e komunës tonë që vijnë nga doganat duhet të mblidhen, ruhen dhe shpenzohen ndershmërisht e pa hile nga financieri, për gjithë kohën që ky është në detyrë dhe sipas normave të parashikuara në statut. Për të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e bëra, çdo tre muaj u duhet bërë një raport gjykatësve dhe këshilltarëve. Gjykatësit e radhës duhet të regjistrojnë me shkrim me anë të sekretarit gjithë shumën e të ardhurave vjetore, në mënyrë që kjo t'u bëhet e ditur gjykatësve dhe këshilltarëve që do të zgjidhen sërish. Gjykatësit e rinj duhet të kenë të regjistruara në fletore nga dora e sekretarit të gjitha detyrimet, duke specifikuar se çfarë u mbetet të paguajnë

mbledhja e detyrimeve¹⁰⁵, nga doganat¹⁰⁶, nga njësitë e matjes e të peshave¹⁰⁷, nga gjobat¹⁰⁸, nga konfiskimi i pronave të tradhtarëve¹⁰⁹, nga pasuritë e qytetarëve që nuk kishin trashëgimtarë¹¹⁰, etj., akumuloheshin dhe ruheshin në thesarin e komunës¹¹¹. Me mbledhjen e detyrimeve fiskale merreshin njerëz të ngarkuar posaçërisht nga komuna, të cilët duhej të punonin me ndershmëri dhe pa hile¹¹². Për ata qytetarë që nuk i shlyenin në kohë detyrimet ose ishin debitorë ndaj komunës, vepronte autoriteti shtrëngues i gjykatësve¹¹³. Një pjesë të të ardhurave, komuna i përdorte për nevojat e saj të brendshme, për rregullimet dhe meremetimet e nevojshme të kështjellave dhe mureve të qytetit, për ambasadorët¹¹⁴ që dërgonte kohë pas kohe pranë komunave të tjera të kohës brenda e jashtë vendit, për të zgjidhur probleme të veçanta që lindnin në marrëdhëniet midis tyre, për të përballuar rrogën e noterëve apo të specialistëve të tjerë që silleshin nga jashtë herë pas here për nevojat e komunës etj¹¹⁵.

Krahas asamblesë popullore, fisnikëve, peshkopit, gjykatësve, këshillit e financierëve, duhet mbajtur parasysh një tjetër faktor pushteti në jetën qytetare shkodrane, noterët. Statutet ishin shprehje e ngulitjes me shkrim të kushtetutave qytetare dhe të jetës juridike. Pothuajse për të gjitha veprimet ligjore ato parashikonin nxjerrjen e një dokumenti prej

financierët e mëparshëm, çfarë borxhi ka komuna ndaj privatëve. Por nuk duhet të regjistrohen dhe t'u kalohen gjykatësve të rinj detyrimet personale që financierët duhet të heqin nga xhepi i tyre. Rroga e financierëve duhet të jetë katër hyperperë për njërin dhe për tjetrin”.

¹⁰⁵ Po aty, kreu 108.

¹⁰⁶ Po aty, kreu 65, 105.

¹⁰⁷ Po aty, kreu 64, 109.

¹⁰⁸ Po aty, kreu 19, 22, 24, 30, 64, 67, 68, 69, 70, 72, 73, 74, 77, 79, 80, 81, 84, 85, 86, 93, 115, 151, 152, 223, 229, 246, 249, 250, 251, 260, 262.

¹⁰⁹ Po aty, kreu 12, 13, 16, 21, 25, 28, 29, 36, 39, 40, 42, 46, 47, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 71, 76, 78, 87, 163, 184, 187, 201, 203, 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 216, 218, 230, 231, 232, 233, 237, 238, 239, 240, 242, 243, 256, 257, 261, 265.

¹¹⁰ Po aty, kreu 228.

¹¹¹ Po aty, kreu 198.

¹¹² Po aty, kreu 4, 278.

¹¹³ Po aty, kreu 108.

¹¹⁴ Po aty, kreu 138.

¹¹⁵ Po aty, kreu 91.

¹¹⁵ Luan Malltezi, *Qytetet e bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas*, “8 Nëntori”, Tiranë, 1988, f. 34.

një noteri¹¹⁶. Noteri, i cili shpesh kryente edhe punën e mësuesit të shkollës¹¹⁷, ishte në këtë mënyrë i lidhur ngushtë me jetën ekonomike, sociale e politike të komunës.

Për rolin dhe rëndësinë e veçantë, si dhe për përgjegjësitë e tij tregon edhe një dispozitë e Statuteve të Shkodrës, ku ai si i vetmi funksionar duhej të zgjidhej nga populli dhe paria e qytetit së bashku me gjykatësit, këshilltarët dhe financierët. “Noteri duhet të zgjidhet nga gjykatësit, këshilltarët dhe të gjithë burrat e shquar të qytetit tonë me anë të votave. Shpallet noter ai që grumbullon më shumë vota. Ai duhet të përmbushë urdhrat e tij dhe urdhrat që i jepen nga gjykatësit dhe këshilltarët siç përcaktohet në statutet e qytetit tonë. Nëse nuk pranon të bindet ai e humbet postin dhe paguan pesëdhjetë hyperperë gjobë, gjysmën kontit e gjysmën komunës. Noteri është i detyruar që brenda tetë ditëve të hedhë në letër vendimet e marra nga gjykatësit, gastaldët dhe arbitrat e zgjedhur për çështje shitje, këmbimi, dhurimi, paje dhe çdo veprimi tjetër të bërë në bazë të arsyes, të statutit apo të testamentit në çdo kohë e në çdo orë për llogari të qytetarëve tanë ose bujtës. Noteri nuk mund të përpilojë asnjë dokument në mirëbesim, por vetëm në praninë e të dyja palëve. Noteri nuk duhet të lëshojë më shumë dokumente nga ç`kërkojnë gjykatësit”¹¹⁸.

Prej tij varej sekretari i gjyqit, i zgjedhur nga Këshilli dhe gjykatësit, e përgjegjës para këtyre të fundit¹¹⁹. Qytetarët shkodoranë, kur paraqisnin dokumentacionin për gjyq¹²⁰, kur shkruanin teste¹²¹, kur kërkonin të shisnin pronat e tyre¹²² e kur kishin të bënin me çështje civile të kësaj natyre¹²³, patjetër që duhet të kishin autorizimin e noterit të shkruar dhe vulosur vetë me dorën e tij¹²⁴. Noterët në mjaft raste

¹¹⁶ Statuti di Scutari ..., kreu 117, 120, 130, 140, 189, 247, etj.

¹¹⁷ O. J. Schmitt, *vep. e përm.*, f. 139.

¹¹⁸ Statuti di Scutari ..., kreu 93.

¹¹⁹ Po aty, kreu 105.

¹²⁰ Po aty, kreu 117, 120, 267.

¹²¹ Po aty, kreu 185.

¹²² Po aty, kreu 176: “Kur një person dëshironte të shiste një pronë të tijën, së bashku me palën blerëse shkonin te noteri me dy ose tre dëshmitarë secila. Noteri përpilonte aktin noterial të shitjes në fjalë. Nëse blerja ose shitja bëhej në tjetër mënyrë, ajo quhej e pavlefshme”.

¹²³ Po aty, kreu 130.

¹²⁴ Po aty, kreu 274. *Acta et Diplomata Res Albaniae Mediae Aetatis Illustrantia* (më tej: *Acta Albaniae*), (collegerunt et digesserunt Dr. Ludovicus de

parapëlqeheshin me kombësi të huaj, për të shtuar shkallën e besueshmërisë së tyre¹²⁵. Për këtë qëllim, noterët rekrutoheshin jo rrallë edhe nga radhët e klerit¹²⁶.

Përveç noterit, nga autoritetet politike të sipërpërmendura vareshin edhe një radhë nëpunësish të tjerë civilë si: semeci¹²⁷, otargu¹²⁸, korrieri¹²⁹, vataku¹³⁰, mbledhësit e detyrimeve¹³¹, gastaldët e arbitrat¹³². Këta dy të fundit mereshin me çështjet e shitjeve, këmbimit, dhurimeve e me probleme të natyrës civile¹³³.

Të gjithë nëpunësit duhet t'i shërbenin me përkushtim dhe besnikëri të lartë komunës. Në rast se ata gjatë ushtrimit të detyrës pësonin ndonjë dëmtim fizik, siç ishin plagosjet, karakteristike për ambientin dhe shoqërinë mesjetare, të gjitha shpenzimet për kurimin e tyre i paguante komuna¹³⁴.

Krahas gjykatësit dhe noterit, një vend jo pak të rëndësishëm në fushën e gjyqësorit zinte figura e avokatit¹³⁵, veprimtarinë e të cilit statuti e përvijonte si më poshtë: *“Avokatët e komunës nuk mund të pyesnin ose të përgjigjeshin pa pasur autorizimin e palës së interesuar. Mund ta bënin këtë vetëm kur dikush paraqitej dhe deklaronte në prani të gjykatësve se “ky është avokati im”. Vetëm kështu ky avokat fitonte të drejtën të përgjigjej dhe të pyeste lirisht e pa hile, si për veten e tij. Nëse vërtetohej me prova se nuk e bënte detyrën me ndershmëri, ai shkarkohej nga detyra dhe detyrohej t'i paguante palës që e kishte pajtuar dëmin. Avokati duhej paguar me jo më shumë se një grosh për çdo dymbëdhjetë*

Thalloszy, Dr. Constantinus Jirecek et Dr. Emilianus de Sufflay), volumen I, (Annos 344-1343 Tabulamque geographician continens), dok. nr. 744, Vindobonae MCMXIII, ribotim, Tiranë, Prishtinë: “Dukagjini” – Pejë, 2002.

¹²⁵ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I, f. 265.

¹²⁶ N. Pounds, *The Medieval City*, Greenwood Press, London, 2005, f. 109.

¹²⁷ *Statuti di Scutari ...*, kreu 106.

¹²⁸ *Po aty*.

¹²⁹ *Po aty*, kreu 117, 137.

¹³⁰ *Po aty*, kreu 137.

¹³¹ *Po aty*, kreu 108.

¹³² *Po aty*, kreu 93.

¹³³ *Po aty*.

¹³⁴ *Po aty*, kreu 245: *“Kur dikush dëmtohet duke i shërbyer komunës, gjykatësit duhet të heqin nga fondet e saj shpenzimet për barnat, për mjekun, si dhe për ditët e humbura nga i dëmtuari, përveç rastit kur ky është plagosur për faj të tij”*.

¹³⁵ *Po aty*, kreu 107, 117, 129, 152.

*grosh. Avokati i pajtuar nga njëra palë nuk mund ta braktiste atë dhe të kalonte në palë tjetër. Nëse vepronte kështu, avokati duhej dënuar me katër hyperperë sklavonie*¹³⁶. “Në rast se në gjyq paraqitej një avokat që dëshmonte përpara gjykatësve dhe personit që e kishte pajtuar si avokat dhe nëse dëshmia nuk kundërshtohet nga klienti i tij, atëherë dëshmia e avokatit konsiderohet e vërtetë dhe e vlefshme, sikur ta kishte thënë vetë klienti i tij. Nëse kundërshtohet nga personi që e kishte zgjedhur për avokat të tijin, dëshmia e këtij të fundit konsiderohet e pavlefshme dhe nuk merret parasysh”¹³⁷.

Në dallim nga funksionarët e tjerë të komunës, mandati i avokatit zgjaste më shumë se një vit. “Asnjë funksionar nuk mund të qëndrojë në detyrë më shumë se një vit, me përjashtim të avokatit...”¹³⁸. Kjo ndoshta, për faktin se ai nuk bënte pjesë në instancat e organeve ekzekutive të qeverisë së qytetit.

Në shërbim të komunës, për ruajtjen dhe sigurimin e rendit e të qetësisë publike të saj, ishin edhe rojet e qytetit, të cilët ishin të ngarkuar të qëndronin në detyrë gjithë natën deri në mëngjes¹³⁹. Kujdesi që tregonin rojet e komunës së Shkodrës, përmendej edhe në letrat e senatit të Raguzës¹⁴⁰.

Ata komandoheshin prej kapedanëve, të cilët duhej të ishin në gatishmëri dhe nën urdhrat e Këshillit dhe Kolegjit të Gjykatësve si ditën, ashtu edhe natën¹⁴¹. Në qoftë se kapedanët e qytetit bënin ndonjë veprim me kokën e tyre ose pa pasur urdhrin e gjykatësve, ata shkarkoheshin nga posti tyre dhe dënoheshin me gjobë në vlerë monetare¹⁴². Kjo mbrojtje e kujdesshme dhe e vazhdueshme në portat dhe muret e komunës, ditën dhe natën, nëpërmjet shërbimit të detyrueshëm të rojeve, evitonte

¹³⁶ *Po aty*, kreu 107.

¹³⁷ *Po aty*, kreu 129.

¹³⁸ *Po aty*, kreu 152.

¹³⁹ *Po aty*, kreu 81: “Urdhërojmë që rojet e ngarkuara me ruajtjen e qytetit tonë të qëndrojnë në detyrë gjithë natën deri në mëngjes. Nëse dikush e braktis detyrën dhe shkon në shtëpi në shtëpi për të fjetur, ose nuk paraqitet fare në garnizon, ai duhet të paguajë gjithë dëmin që mund të jetë bërë atë natë. Por edhe sikur të mos jetë bërë ndonjë dëm, ai detyrohet të paguajë një gjobë prej dymbëdhjetë groshës, gjysmën kontit dhe gjysmën garnizonit”.

¹⁴⁰ *Acta Albaniae*, I, dok. nr. 676.

¹⁴¹ *Statuti di Scutari ...*, kreu 86.

¹⁴² *Po aty*.

rezikun e jashtëm, ruante qetësinë brenda qytetit nga keqbërësit, pijanecët, hajdutët¹⁴³, endacakët¹⁴⁴, vrasësit¹⁴⁵ dhe vagabondët¹⁴⁶.

Gjithashtu, një tregues sinjifikativ që dëshmonte për forcën e ligjit dhe të organeve politike e ekzekutive të komunës, ishte edhe prania e institucionit të riedukimit ose vuajtjes së dënimit, siç ishte burgu¹⁴⁷. Në qytetin e Shkodrës, ky institucion evidentohet jo vetëm në kohën e hartimit të statuteve, por edhe në fillim të gjysmës së dytë të shekullit XV. Për këtë, bënte fjalë një dispozitë shtesë e statuteve, që mban datën 25 prill 1461¹⁴⁸, periudhë kjo, kur qyteti i Shkodrës ndodhej nën sundimin venecian.

Përveç garnizonit të rojeve dhe burgut si institucione detyrimi dhe shtrëngimi, në raste sulmi ose agresioni nga jashtë¹⁴⁹ apo edhe si pasojë e konflikteve të brendshme me përmasa serioze, komuna kishte edhe ushtrinë e saj, e cila mobilizohej për luftë vetëm me urdhër të mbretit¹⁵⁰. Ushtarët e saj ishin rrogëtarë dhe drejtoheshin prej kapedanëve ushtarakë, të cilët paguheshin dyfish më tepër se vartësit e tyre¹⁵¹. Dezertimi nga radhët e ushtrisë sanksionohej me një gjobë të lartë në vlerë monetare. *“Nëse dikush është regjistruar për të shkuar në luftë dhe nuk shkon, të dënohet me 8 hyperperë gjobë si dhe të shlyejë të gjithë dëmin që i shkaktohet komunës për shkak të braktisjes së detyrës”*¹⁵².

Me forcat e veta policore e ushtarake, komuna përpiquej të mbronte edhe juridiksionin e saj që përfshinte një numër fshatrash përreth, nga rreziku i vazhdueshëm që i vinte nga komunat fqinje. *“Mbrojtja e kufijve të komunës dhe fshatrave përreth (që përbënin burimin e nevojshëm me*

¹⁴³ *Po aty*, kreu 203, 208, 209, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 222, 255, 259.

¹⁴⁴ *Po aty*, kreu 255.

¹⁴⁵ *Po aty*, kreu 224, 225.

¹⁴⁶ *Po aty*, kreu 92, 238, 239, 240, 242, 243, 244, 246.

¹⁴⁷ *Po aty*, kreu 185.

¹⁴⁸ *Po aty*, kreu 279.

¹⁴⁹ *Acta et Diplomata Res Albaniae Mediale Aetatis Illustrantia*, (collegerunt et digesserunt Dr. Ludovicus de Thalloczy, Dr. Constantinus Jirecek et Dr. Emilianus de Sufflay), volumen II, (Annos 1344-1406 continens), dok. nr. 62: “(1349-1351) *Qyteti i Budvës duhet të aktivizohet me ushtri kundër Shkodrës*”, Vindobonae MCMXIII, ribotim, Tiranë, Prishtinë: “Dukagjini” – Pejë, 2002.

¹⁵⁰ *Statuti di Scutari ...*, kreu 85.

¹⁵¹ *Po aty*, kreu 85.

¹⁵² *Po aty*, kreu 85.

produkte bujqësore e blegtorale për furnizimin e qytetit dhe për eksportin e mallrave në tregjet e jashtme L. Malltezi) ishte një nga shqetësimet e vazhdueshme të komunave dhe një masë e domosdoshme për të përballuar grindjet e luftërat me fqinjët”¹⁵³.

Krahas organeve të brendshme politike e ekzekutive të qeverisë, komuna kishte edhe strukturat e saj për marrëdhëniet me jashtë. Kjo instancë përfaqësohej përmes figurës së ambasadorit, i cili duhej t'i bindej urdhrave të komunës dhe nuk duhej të refuzonte kryerjen e misionit diplomatik jashtë vendit¹⁵⁴. Ambasadorët përfaqësonin sovranin e tyre dhe flisnin në emër të tij. Çfarëdolloj fyerje ndaj tyre, drejtohej kundër sovranit; çdo nder që u bëhej ambasadorëve, i adresohet sovranit të tij.

Paralel me institucionet qeverisëse të komunës, ishin edhe simbolet e sovranitetit qytetar, ku bënin pjesë: vula, njësitë e matjes e të peshave. Vula e qytetit ruhej me shumë adhurim si emblemë e mëvetësisë së komunës¹⁵⁵. Falsifikimi i saj në qytetin e Shkodrës parashikonte sanksione të rënda. *“Nëse provohet se dikush ka falsifikuar vulën e komunës, masën, formën dhe ngjyrën e saj për qëllim të mbrapshtë, të dënohet me njëqind hyperperë, gjysma e të cilëve i shkon gjykatës dhe komunës dhe gjysma tjetër denoncuesit. Falsifikuesi dhe tradhtari nuk duhet të kenë të bëjnë me komunën”¹⁵⁶.*

Ajo ruhej së bashku me dëshmitë e privilegjeve në arkën e komunës, e cila kishte tre çelësa, dhe çdo njëri prej gjykatësve e kishte nga një të tillë¹⁵⁷. Një dokument i vulosur me vulën e komunës kishte vlerën e një akti noterial¹⁵⁸.

¹⁵³ L. Malltezi, *vep. e përm.*, f. 34.

¹⁵⁴ *Statuti di Scutari ...*, kreu 91: “Ambasadori i zgjedhur duhet t'i bindet urdhrave të komunës dhe në rast se refuzon të niset për kryerjen e misionit jashtë shtetit, të detyrohet të paguajë për dënimin njëzet e pesë hyperperë”. (Termi “ambasador” u përdor për herë të parë në shekullin XIV. Zhvillimi i tij si institucion lidhet me diplomacinë e Venedikut dhe të qyteteve të tjera italiane. Marrë nga: P. Nathanaili, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare* (Nga origjina e deri më sot), Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2006, f. 82).

¹⁵⁵ O. J. Schmitt, *vep. e përm.*, f. 147.

¹⁵⁶ *Statuti di Scutari ...*, kreu 248.

¹⁵⁷ *Po aty*, kreu 88.

¹⁵⁸ *Po aty*, kreu 94: “Nëse noteri nuk e përfundon brenda tetë ditëve aktin zyrtar të vendimit të gjykatësve, ky vendim mund të shkruhet në një kartë me vulën e

Përveç vulës së komunës, Statutet e Shkodrës njihnin edhe autoritetin juridik të vulës ftuese të mbretit serb, me të cilën thirrreshin në gjyq qytetarët¹⁵⁹, si dhe të vulës peshkopale¹⁶⁰. Grabitja e vulës qytetare përbënte një cenim të rëndë të autonomisë komunale.

Një tjetër emblemë e sovranitetit ishin njësitë e matjes e të peshave¹⁶¹, sidomos për prodhimet bujqësore e blegtorale. Kontrollorët e tyre duhej të kishin mandatin e komunës dhe të ishin njerëz sa më të ndershëm¹⁶². Për mosrespektimin e standardeve të njërive të matjes e të peshave nga ana e tregtarëve ose e qytetarëve të ndryshëm, dispozita e statutit parashikonte gjobë në vlerë monetare¹⁶³. Në këtë mënyrë, ato përfaqësonin edhe një burim të ardhurash për komunën e Shkodrës.

Përsa i përket gjuhës zyrtare që përdornin institucionet dhe administrata në qytetin e Shkodrës gjatë gjysmës së parë të shekullit XIV, mund të themi se ishte dalmatishtja e Shkodrës¹⁶⁴ me ndikim nga venecianishtja e shekullit XV, pasi në këtë gjuhë është shkruar edhe libri juridik i kësaj komune qytetare. Megjithatë, nuk duhet të kenë munguar edhe aktet administrative të komunës qytetare të Shkodrës në gjuhën latine dhe atë serbe. Në mbështetje të këtij mendimi, albanologu çek i fillimit të shekullit XX, Kostandin Jiriçek citonte: “Në sekretari të qytetit aktet u shkruajshin vetëm në latinisht. Në 1330 përmendet një “Clemens filius Gini, notarius communis Scutari” shkruar për dokumente në gjuhën serbe”¹⁶⁵.

Organizmat qeverisëse të qytetit të Shkodrës në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XIV, të trajtuara më lart, tregonin për një mirëfunksionim midis hallkave institucionale të komunës, si njësi territoriale e politike me të drejtën e vetëqeverisjes ose e administrimit më vete. Panorama e përgjithshme e këtyre institucioneve u afrohej deri diku modeleve të organizimit komunal mesjetar të qyteteve italo-dalmatine dhe atyre të Europës Perëndimore.

komunës, që ka vlerë të njëjtë me dokumentin e përpiluar nga noteri”. Kreu 123, 188.

¹⁵⁹ *Po aty*, kreu 3.

¹⁶⁰ *Po aty*, kreu 155.

¹⁶¹ *Po aty*, kreu 64.

¹⁶² *Po aty*.

¹⁶³ *Po aty*, kreu 64.

¹⁶⁴ O. J. Schmitt, *vep. e për.*, f. 114.

¹⁶⁵ K. Jireçek, *Shkodra e krahina e saj ...*, f. 118.

*S u m m a r y*THE GOVERNING INSTITUTIONS OF THE COMMUNE OF SHKODRA
THE FIST HALF OF 14TH CENTURY

The statuaries of Shkodra during the early decades of the 14th century yield important data on the development and the institutional organisation of the urban commune of Shkodra in the middle ages. The statuaries should have been in two copies to which all the local inhabitants were obliged to act upon as well as the foreigners entering the city.

The sovereign rights on the city of Shkodra during this period belonged to the Serbian monarchy, the authority of which was represented by the earl, an important political figure that respected the communal selfadminstation. Another important governmental body of the commune of Shkodra was the citizens' assembly that was summoned on the day of Saint Mark on the 25th of April in the presence of the bishop and the local nobility during which would be selected three judges, eight counsellors and the two financiers of the city. All of them formed the Commune's Council and the mandate for the governing of the city was for one year. The College of the Judges and the Commune's Council comprised the government of the city were all the decisions would be approved and implemented with consensus and a majority of votes. In all the pyramidal structure of the commune's governing of Shkodra, the judges played an important role. Parallel to the governing institutions of the commune, were the symbols of the civic sovereignty part of which were the seal and the measuring units and the weights.

All these governmental institutions testify that the city of Shkodra situated between East and West was aiming to integrate and follow the rhythm of the time that during this period was oriented toward the northern part of the western Adriatic.